



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## NJOFTIM PËR KONTRATË

*TENDERI*

*(Punë)*

*Procedurë e hapur*

*Në përputhje me Nenin 6 të Rregullave të Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës  
(Shtator 202)*

Data: 27.09.2022

Nr. i Prokurimit: BQK 22 044 321

### I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimeve	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni:	038 222 055/452

### II LËNDA E KONTRATËS

#### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: : <b>“Renovimi i hapësirës së garazhës për nevojat e BQK-së”</b>
Lloji i prokurimit: Punë
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): n/a
Variantet pranohen: n/a
Ndarja në Pjesë: JO

### III INFORMACIONE PËR PUNËN

Qëllimi i kësaj kontratë është që të përzgjidhet kontraktuesi për të realizuar këtë kontratë që të kryejnë në mënyrë profesionale punët e Renovimit të hapësirës së garazhës për nevojat e BQK-së, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike / paramasa dhe parallogaria ofertuesit të interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t’u shpërndahet.

#### IV KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE:

Të gjitha kompanitë e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me aplikacionet e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:	
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	<p><b><u>Kërkesa 1:</u></b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p><b><u>Evidenca 1:</u></b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin 3 të dosjes së tenderit.</p>
	<p><b><u>Kërkesa 2:</u></b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 2:</u></b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p><b><u>Kërkesa 3:</u></b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata kompetete.</p> <p><b><u>Evidenca 3:</u></b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinali)</p>
	Dokumentet për kërkesën 2 dhe 3, duhet të dorëzohen nga të gjithë operatorët ekonomikë.
Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale	<p><b><u>Kërkesa 4:</u></b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit (numri unik i biznesit, ARBK).</p> <p><b><u>Evidenca 4:</u></b> Kopja e certifikatës së biznesit.</p> <p><b><u>Kërkesa 5:</u></b> Regjistrimi i TVSH-së.</p> <p><b><u>Evidenca 5:</u></b> Certifikata e TVSH-së (kopje)</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi dhe deklarata si në vijim:</p> <p>a. <b>një deklaratë e qartë</b> ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;</p> <p>b. <b>një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët</b>, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë</p>

	<p>individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurë të njëjtë të prokurimit;</p> <p>c. <b>një deklaratë të nënshkruar</b> nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe</p> <p>d. Të gjithë anëtarët e grupit të tillë duhet të <b>jenë të përshtatshëm</b> dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në kërkesat 1,2,3,4,5.</p>
<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p>	<p><b>Kërkesa 5:</b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar të realizuar tre vitet e fundit, në vlerë jo më pak se 100,000.00 euro, (në rast të konzorciumit këtë kusht duhet ta plotësojë kompania lidere).</p> <p><b>Evidenca 5:</b> Dokument/dëshmi nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e auditura financiare ose deklaratat vjetore tatimore të dorëzuara në ATK.</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p>	
	<p><b>Kërkesa 6:</b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të natyrës së ngjashme të punëve ndërtimore, gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë).</p> <p><b>Evidenca 6:</b> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi listën origjinale të nënshkruar dhe vulosur të kontratave të ngjashme (së paku dy kontrata) të punëve ndërtimore gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë), lista duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga ofertuesi, si dhe të bashkëngjiten kontratat dhe referencat që evidentojnë performimin e tillë, nëse kontrata është realizuar me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është kryer pagesa). Lista duhet t'i përmbajë të dhënat si: datën e nënshkrimit, datën e përfundimit, titullin e kontratës, autoritetin e kontratës, vlerën e projektit për kontratat e prezentuara në listë.</p> <p><b>Kërkesa 7 :</b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Katalogët - me specifikat teknike detale të artikujve të ofruara për këto materiale kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punët e muratimit</li> <li>- Rampës Elektrike</li> <li>- Punët e dyshemesë</li> <li>- Dyerve dhe dritareve</li> <li>-</li> </ul> <p><b>Evidenca 7:</b> Katalogët - me specifikat teknike të artikujve të ofruar dhe e shënjuar në katalog qartë produktet e ofruara, ashtu siç janë kërkuar.</p>

	<p><b><u>Kërkesa 8:</u></b> Mesatarja vjetore e të punësuarve (që janë në listën e pagave në ATK) në tri vitet e fundit duhet të jetë minimum 10 të punësuar (në rast të konzorciumit këtë kusht duhet ta plotësojë vetëm kompania lidere).</p> <p><b>Evidenca 8:</b> Të dorëzohet lista e të punësuarve-vërtetim nga ATK.</p> <p><b><u>Kërkesa 9:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional dhe punëtorëve të kompanisë që do t'i angazhojë në këtë projekt me këto të dhëna: Emrin, Mbiemrin, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani (të profileve të ndryshme).</p> <p><b>Evidenca 9:</b> Lista e stafit profesional dhe e punëtorëve të ofertuesve, me të dhënat: emrin, mbiemrin, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani duhet të dorëzohet në origjinal nga ofertuesit.</p> <p><b>Kërkesa 10:</b></p> <p><b>10.1</b> Një inxhinier të ndërtimtarisë, së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit- <b>i cili duhet të jetë menaxher i projektit.</b></p> <p><b>10.2</b> Një inxhinier ose bachelor i diplomuar i ndërtimtarisë, së paku tri vite përvojë pune pas diplomimit- <b>i cili duhet të jetë menaxher i punishtes.</b></p> <p><b>10.3</b> Një inxhinier të Makinerisë, së paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit.</p> <p><b>Evidenca 10:</b> Për kërkesën <b>10.1, 10.2 dhe 10.3</b>, ofertuesit duhet të ofrojnë dëshmi kopjen e noterizuar nga origjinali të diplomës universitare apo certifikatë nga noteri, CV-ja kopje mbi përvojën e punës, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt, atëherë marrëveshja duhet të jetë kopje e noterizuar nga origjinali. Vendimi me shkrim për udhëheqësin e punishtes dhe për menaxherin e projektit, duhet të dorëzohet në origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga të dyja palët.</p>
	<p><b>Kërkesa 11 :</b> Një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike, të cilat garantohen që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 2, si pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit.</p> <p><b>Evidenca 11:</b> Të dorëzohet deklarata e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike, të cilat garantohen që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 2, si pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit.</p>
	<p><b><u>Kërkesa 12:</u></b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e menaxhimit të projektit, duke përfshirë vendosjen e ekipeve në çdo aktivitet kohën e fillimeve dhe kompletimit të aktiviteteve dhe zbatimit të përgjithshëm të projektit.</p>
<p>III.1.3) Inspektimi i kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale</p>	<p>Banka Qendrore mund të dëshirojë, me shpenzimet e tij, të kryejë një inspektim të operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit të kapaciteteve disponuese, vërtetimin e cilësisë, mjetet për transport dhe çdo informatë tjetër që është e nevojshme dhe e cila dëshmon që ofertuesi mund të realizojë kontratën.</p>

## V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: E hapur

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi i përshtatshëm, çmimi më i lirë”

## VII INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit : afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit 11.10.2022, ora 14:00 në e-mail adresën <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 10.10.2022, ora 14:00.
Dokumentet me pagesë: Jo
Kompanitë e interesuara për pjesëmarrje në këtë aktivitet Prokurimi mund të bëjnë vizitën e objektit me datë: 06.10.2022, në ora 10:00.
Siguria e tenderit: 2,300.00 Euro ( me vlefshmëri 120 ditë, nga data e hapjes së ofertave)
Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditë më shumë se sa afati i realizimit.
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e hapjes
Afati i fundit i dorëzimit të aplikacioneve : 13.10.2022, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave: 13.10.2022, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.

## VIII INFORMATA PLOTËSUESE

### VIII.1 ANKESAT

Në përputhje me Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore.

### VIII.2 ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimeve.	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni:	038 222 055/452